



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJ & IP-A

Nr. 1508 Prot.

Tiranë, më 24.09.2025

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune, sa më poshtë:

- **DREJTORIA MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJ & IP-A**
(Sektori i Sallave dhe Shërbimeve të tjera):
• Specialist Fonie - Salla e Madhe/e Koncerteve

I. KRITERET PËR KANDIDATËT

I.1. KRITERE TË PËRGJITHSHME:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje.
5. Të mos ketë marrë ndonjë masë disiplinore për largim nga detyra.

I.2. KRITERE TË VEÇANTA:

1. Të zotërojë, së paku, diplomë të ciklit të parë të studimeve "Bachelor";
 - 1.1. Në rast se studimet janë kryer në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjisacionit në fuqi.
- 1.2. Kandidatët të cilët kanë përfunduar Universitetin e Arteve kanë prioritet;
2. Të ketë së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në pozicionin për të cilin konkuron ose të ngjashme me të;
3. Të njohë programet bazë kompjuterike për montazh audio dhe transmetim;
4. Të jetë njohës i një prej 5 (pesë) gjuhëve te huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
5. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të ketë aftësi të punojë në ekip;
6. Të jetë fleksibël dhe të ketë aftësi menaxhimi në situata të ndryshme në punë;
7. Të ketë vlerësimë pozitive pune nga punëdhënësi i fundit.

Kritere kualifikuese përbëjnë kriteret e përgjithshme, së bashku me kriteret e veçanta, pikat 1, 2 dhe 3. Mosplotësimi i këtyre kritereve përbën shkak për skualifikim të kandidaturës.

II. PËRMBAJTJA E DOSJES (DOKUMENTACIONI)

Dokumentacioni që duhet të përmbajë çdo dosje e kandidatit:

Sa më sipër, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ-P/A:

1. Letër motivimi për pozicionin e punës për të cilin konkuron;
2. Fotokopje të noterizuar të diplomës që vërteton kryerjen e arsimit të lartë. Për kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit, dokumenti për njohjen dhe njehsimin e diplomës;
3. Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
4. Fotokopje e noterizuar të librezës së punës, që vërteton përvojën në punë;
5. Jetëshkrimi (CV) në gjuhën shqipe, ku të jetë përfshirë edhe adresa e postës elektronike, i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
6. Letër reference/vlerësimi pune nga punëdhënësi i fundit;
7. Dokumente të tjera plotësuese si: fotokopje e noterizuar e certifikatave apo diplomave të trajnimeve ose kualifikimeve pasuniversitare në fushën përkatëse, nëse ka;
8. Dëshmi të mbrojtjes së një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
9. Kopje e kartës së identitetit;
10. Vetë deklarim i gjendjes gjyqësore;
11. Dëshmi e gjendjes mjekësore.

III. DORËZIMI I DOSJES, AFATI DHE NJOFTIMET

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, dorëzohet fizikisht, nga vetë kandidati, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A në Universitetin e Arteve, nga data 29.09.2025 deri më datë 13.10.2025, nga ora **09:00** deri në orën **14:00**.

Vetëm kandidatët të cilët do të plotësojnë kriteret kualifikuese, do të njoftohen për të marrë pjesë në fazën e mëtejshme.

Kandidatët e kualifikuar do të informohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A përmes postës elektronike, si dhe për çdo pyetje apo paqartësi, çdo ditë, nga ora 09:00 deri në 14:00.

IV. VLERËSIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët të cilët do të vazhdojnë në fazën e mëtejshme të konkurrimit do të vlerësohen si më poshtë:

- Vlerësimi i testit me shkrim – deri në 60 pikë. Kandidati duhet të marrë minimalisht 30 pikë në mënyrë që të vazhdojë me vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistën e strukturuar me gojë.
- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimit, vlerësimin e përvojës në punë dhe vlerësimin e trajnimeve e kualifikimeve të lidhura me fushën – deri në 15 pikë.
- Vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, që lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës – deri në 25 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi sistemet e mikrofonimit, në varësi të burimeve të tingullit;
- Njohuritë mbi aparaturat (software, hardware) në regjistrimin dhe manipulimin e tingullit (mikrofon, compressor, reverb, delay, etj.)

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 [www uart.edu.al](http://www uart edu al)

Miratoi: M. Xibraku DMBNJ

Konc: A.Kusuri Sek. Jur.

Ekz: 2 (dy) kopje

Faqe 3 nga 3